



# Fond Pensioni Vullnetar



*Njësia e Sigurimeve*



## Pyetje dhe Pergjigje

### ➤ **Përse një Fond Pensioni Vullnetar?**

- Fondet e Pensioneve Vullnetar janë krijuar për t'ju dhënë mundësi individëve që të sigurojnë një pension shtesë përveç pensionit shtetëror.
- Aderimi në një fond pensioni vullnetar është një domosdoshmëri për këdo që kërkon të ruaj të njëjtin standart jetese edhe gjatë periudhës së pensionit pasi pensioni shtetëror nuk do arrij të siguroj një pension adekuat.
- Në shtetet anëtare të Bashkimit Europian këto skema janë shumë të përhapura, ku individët arrijnë të sigurojnë një pension të kënaqshëm përveç atij shtetëror.

### ➤ **Si funksionon një Fond Pensioni Vullnetar?**

- Për tu bërë pjesë e Fondit të Pensionit Albsig duhet të nënshkruhet kontrata e anëtarësimit.
- Anëtari për zgjedh shumën e kontributeve mujore që kërkon të kursejë, të cilat investohen vetëm në obligacione afatgjatë të Shtetit Shqiptar.
- Shuma e pensionit që përfitohet në të ardhmen do të varet nga shuma e kontributeve, norma e kthimit të fituar nga investimet e kontributeve, periudha e investimit si dhe nga kohëzgjatja e pagesave të pensionit në të ardhmen. Shuma minimale e kontributit është 1,000 lekë.
- Kontributet derdhen në bankën depozitare e cila është Banka e Tiranës.
- Autoriteti i Mbiqyrjes Financiare (AMF) ushtron mbiqyrje mbi aktivitetet e Shoqërisë Administruese, të Fondit dhe bankës depozitare.



## Pyetje dhe Pergjigje

- **Sa të sigurta janë paratë e mia? Ku do investohen këto para?**
  - Siguria Financiare: Asetet e Fondit të Pensionit Albsig do të investohen vetëm në obligacione afatgjatë të Shtetit Shqiptar, i cili ka një rrezik pothuajse zero investimi.
  - Siguri Operacionale: Asetet e fondit ruhen në një regjistër elektronik pranë Bankës së Shqipërisë. Aksesit dhe kontrollit mbi këtë regjistër realizohet vetëm nga Banka Depozitare. Asetet e fondit mbahen të ndara nga asetet e Shoqërisë Administruese apo Bankës Depozitare dhe i bënë asetet e fondit “të paprekshme” për qëllime përfitimi nga Shoqëria Administruese.



## Pyetje dhe Pergjigje

### ➤ **Në qoftë se unë së arrij dot moshën e pensionit, çfarë ndodh me paratë e mia?**

Shuma e akumuluar në Fondin e Pensionit është e trashëgueshme dhe e transferueshme. Asetet në llogarinë e tij do t'i shpërndahen trashëgimtareve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgimime.

Shuma e akumuluar në Fond mund të transferohet në një Fond tjetër të pensionit vullnetar të menaxhuar nga një shoqëri tjetër administruese.

### ➤ **Sa transparent do jetë?**

Çdo anëtar do pajiset me një «username» dhe password ku do mund të aksesoj të dhënat mbi llogarinë e tij për të parë në çdo moment të dhënat mbi kontributet e paguara, çmimin e kuotës, vlerën totale neto të tij dhe çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

Çmimi i kuotës dhe vlera neto e aseteve publikohen çdo ditë në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese ([www.albsiginvest.al](http://www.albsiginvest.al)).



## Pyetje dhe Pergjigje

### ➤ A mund të tërhiqem në çdo kohë?

Anëtari gëzon të drejtën e përfitimeve të shumës së akumuluar pa penalitete vetëm kur mbush kushtin e moshës, 5 vite para moshës ligjore për pension.

Anëtari mund të tërhiqet në çdo kohë, por ligji mbi pensionet vullnetare ka vendosur disa penalitete nëse anëtari vendos të tërhiqet më para se 5 vjet para moshës ligjore të pensionit. Këto penalitete në rast tërheqjeje të parakohshme janë:

- ✓ 2% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë.
- ✓ 5% për çdo tërheqje të parakohshme kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të.
- ✓ 10% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të.
- ✓ 15% për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet data e kontributit të parë përfshirë edhe vitin e 5-te.

Vendosja e penaliteteve për tërheqjet e parakohshme ka për qëllim dekurajimin e anëtarëve për të tërhequr shumen e akumuluar në Fond për qëllime të panevojshme. Këto penalitete janë vendosur në të mirë të anëtarit pasi është më mirë që këto kursime të përdoren në moshën e pensionit.



## Pyetje dhe Pergjigje

- **Si mund ti tërheq unë paratë e mia në momentin e përmbushjes së kushteve ligjore?**

Format e tërheqjes së shumës së akumuluar në Fond janë:

- ✓ Në mënyrë të menjëhershme;
  - ✓ Në mënyrë periodike me kështë;
  - ✓ Kombinim i 2 (dy) mënyrave të mësipërme.
-



## Pyetje dhe Pergjigje

### ➤ Çfarë përfitimesh ka anëtari?

- ✓ Kontributet janë të zbritshme nga paga bruto për efekt llogaritje tatami (paguan më pak tatim mbi të ardhurat);
- ✓ Investimet në fond janë të përjashtuara nga tatimi mbi interesin (në ndryshim nga një investim në mënyrë individuale ku ju tatóhet interesi);
- ✓ Fleksibilitet të lartë në mënyrat e tërheqjes së shumës së akumuluar për pension.
- ✓ Mundësia e kthimit të investimit të akumuluar në pagesa në formë pensioni duke fituar përsëri interes.
- ✓ Depozitim i shumave të vogla nën minimumin e kërkuar të depozitave dhe të bonove dhe mundësia e kryerjes së pagesave në mënyrë automatike çdo muaj.
- ✓ Transparencë e lartë: Anëtarët pajisen me një username dhe password të cilën mund ta përdorin për të monitoruar llogarinë e tyre personale online. Në këtë llogari paraqiten të gjitha kontributet e kryera, norma e kthimit të fondit, dhe informacione të tjera të rëndësishme